

VENDIM
Nr. 476, datë 25.7.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 55, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË
DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 65 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5.3 e vendimit nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.3. Subjektet që janë të detyruara të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, duhet të dorëzojnë në organet tatimore, brenda afateve ligjore edhe në formë shkresore, listëpagesat dhe të dhënat për ndryshimin e numrit të punonjësve për të gjitha periudhat tatimore të vitit 2012.

Për këto periudha tatimore, për efekt të zbatimit të afateve të deklarimit, do të vlerësohet dokumenti i dorëzuar apo i deklaruar më i pari në organin tatimor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha